

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT TE OFERTES

Neni 1. "PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME"

Kompania e sigurimit "ALBSIG" sh.a. këtu e në vazhdim, do të quhet **Siguruesi**. I **Siguruari ose Kontraktuesi**, këtu e në vazhdim do të quhet subjekti fizik ose juridik, pjesmarrës në një tender prokurimi të shpallur nga Autoriteti Prokurues, publik ose jo. **Përfituesi**, këtu e në vazhdim do të quhet, Autoriteti Prokurues që organizon procesin e tenderimit.

Neni 2. "OBJEKTI I SIGURIMIT"

Objekti i kësaj kontrate sigurimi është marrëdhënia juridike në të cilën: **2.1** Siguruesi garanton Përfituesin me vlerën e sigurimit të ofertës, që i Siguruari me cilësinë e ofertuesit do të përmbushë të gjitha detyrimet e tij lidhur me oferten e dhënë, në përputhje me specifikimet e dokumenteve të tenderit. I Siguruari nuk përmbush detyrimet e tij lidhur me oferten e dhënë, nëse: **a)** Tërheq ose ndryshon oferten, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit; **b)** refuzon nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë; **c)** Nuk paraqet sigurimin e kontratës, kur oferta është shpallur fituese ose nuk plotëson ndonjë kusht tjetër, përpara nënshkrimit të kontratës, të përcaktuar në dokumentet e tenderit; **2.2** I Siguruari detyrohet t'i kthejë Siguruesit çdo vlerë monetare të paguar prej tij në rast të ekzakteutimit të vlerës së sigurimit të ofertës, siç përcaktohet në Pikën 1 të këtij neni.

Neni 3. "VLEFSHMËRIA E KONTRATËS"

3.1 Periudha e vlefshmërisë së kësaj kontrate sigurimi, shënohet në formularin e

sigurimit të ofertës. Periudha e vlefshmërisë përcaktohet në dokumentet e tenderit, njoftimin ose ftesën për tender. **3.2** Formulari i sigurimit të Ofertës është i vlefshëm vetëm kur është i shoqëruar me këto Kushte të Përgjithshme të Sigurimit të Ofertës, mbi bazën e të cilës ajo është lëshuar, në të kundërt Formulari i Sigurimit të Ofertës është i pavlefshëm.

Neni 4. "SHUMA E SIGURIMIT"

4.1 Shuma e sigurimit shënohet në formularin e sigurimit të ofertës dhe përbën nivelin maksimal të detyrimit të Siguruesit ndaj Përfituesit dhe të të Siguarit ndaj Siguruesit në rastin e parashikuar në Pikën 2 të Nenit 2 të kësaj Kontrate; **4.2.** Çdo rritje e mundshme e shumës së sigurimit të përcaktuar në Formularin e Sigurimit të Ofertës do të bëhet me miratimin e Siguruesit, kundrejt paraqitjes së një kerkese për këtë shtesë nga Përfituesi. Në rast se Siguruesi miraton rritjen e shumës së ofertës fillestare të sigurimit, i Siguruari duhet të paguajë primin shtesë përkatës dhe të pajiset me një formular të ri të sigurimit të ofertës.

Neni 5. "PRIMI I SIGURIMIT"

Pagesa e primit të sigurimit kryhet pranë Degës ose agjencisë së Siguruesit ku lëshohet formulari i Sigurimit. Pagesa e primit konsiderohet e kryer në momentin e kalimit të vlerës së tij, në llogarinë e Siguruesit.

Neni 6. "EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE"

6.1 Siguruesi paguan shumen e garantuar brenda 15 ditëve nga mbërritja e kërkesës me shkrim nga Përfituesi, me kusht që në shkresë të përcaktohet mospërmbushja e



detyrimeve sipas **Pikës 1/a,b,c të nenit 2**, të kësaj kontrate. Përfituesi duhet të njoftojë Siguruesin brenda 30 ditëve nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit (mospërmbushjes). Në rast mos respektimi të këtij afati Siguruesi ka të drejtë të vendosë për pagesën ose jo të shumës së siguruar; **6.2** I Siguruari është i detyruari dhe përgjegjësi kryesor për përmbushjen e detyrimeve lidhur me paraqitjen e ofertës, kundrejt Përfituesit. I Siguruari me marrjen e dokumentit të kryerjes së pagesës nga Siguruesi në favor të Përfituesit detyrohet të rimbursojë Siguruesin brenda 7 ditëve, për vlerën e pagesës së kryer. Për vonesen tej këtij afati i Siguruari do të paguaj një penaltet prej 0,2 % në ditë të shumës së papaguar, si dhe të çdo shume ligjore tjetër të shpenzuar për arketimin e detyrimit kryesor.

Neni 7. "ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE"

Në rast mosmarrëveshjes, kur ato nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar polica e sigurimit.

Shtojca LMA5393, dt.25.03.2020: "Per Semundjet e Shpalluara" aplikohet ne te gjithë mbulimet, shtojcat,mbulimet shtese, perjashtimet e çdo perjashtimi, dhe çdo mbulimi tjeter te dhene ne kete police.

